

Plani Regjional i Trashëgimisë

Pejë, Klinë, Deçan, Istog, Junik dhe Gjakovë

2012-2015

*"Bashkësitë,
Vendet, Rrëfimet
dhe peizazhet"*



DEÇAN/DEÇANE, GJAKOVË/GRAKOVICA,
ISTOG/ISTOK, JUNK/KLINË/KLINA, PEJË/PEE

JP - EU/CoE Support to the
Promotion of Cultural Diversity (PCDK)

Funded
by the European Union



EUROPEAN UNION



COUNCIL
OF EUROPE

Implemented
by the Council of Europe

Plani Regjional i Trashëgimisë për Kosovën* Perëndimore

Pejë, Klinë, Deçan, Istog, Junik dhe Gjakovë

2012-2015

SHTATOR 2012

* Ky shënim është pa paragjykim të qëndrimeve mbi statusin dhe është në përputhje me Rezolutën 1244 të KS të OKB-së dhe Opinionin e GJND-së për Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës.

Ky dokument është prodhuar brenda kornizës së projektit të përbashkët 'BE/KE - Përkrahja për Promovimin e Diversitetit Kulturor në Kosovë'. Përmbajtja nuk reflekton domosdoshmërisht qëndrimin zyrtar të Bashkimit Evropian dhe/apo të Këshillit të Evropës.

PARATHËNIE

Trashëgimia është gjithkund përreth nesh, duke e formësuar historinë dhe themelet e jetës bashkëkohore. Nuk janë vetëm monumentet dhe objektet e dukshme ato që e përbëjnë trashëgiminë kulturore të ndonjë komuniteti, por janë edhe mënyrat e jetesës, traditat, peizazhet, karakteristikat natyrore, speciet, këngët, vallet, legjendat, artizanatet, lojërat dhe mënyrat e argëtimit, të cilat i japin komunitetit logjikë dhe kuptim. Trashëgimia është ngushtë e lidhur me njerëzit dhe vendin, dhe është detyrë e Planit për trashëgimi që të inkurajojë imagjinatën e komuniteteve dhe të ndikojë mbi mënyrën se si ata e perceptojnë dhe e shfrytëzojnë atë trashëgimi.

Ngjashëm me parimet e zhvillimit të qëndrueshëm, trashëgimia duhet të jetë pjesë e strategjive të përgjithshme për çështjet më të gjera të zhvillimit të integruar si në nivelin lokal, ashtu edhe në atë institucional. Qëllimi i projektit të përbashkët të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës për mbështetjen e Promovimit të Diversitetit Kulturor në Kosovë (PDKK) ka qenë angazhimi më i drejtpërdrejtë i komuniteteve lokale për trashëgiminë e tyre, përmes mbështetjes së krijimit të politikave, të bazuar në standardet e dakorduara, dhe ofrimit të asistencës për zbatimin e tyre përmes një varg instrumentesh dhe projektesh.

Përmes Planit të trashëgimisë ndërlidhen mënyra të ndryshme se si trashëgimia prek pjesë të ndryshme të jetesë sonë dhe i shndërron ato në një strategji funksionale për të ardhmen. Sikurse që trashëgimia i takon të gjithëve, ashtu edhe Plani për trashëgimi është bazuar në një proces me pjesëmarrje intensive, i cili i inkurajon aktorët vendorë të marrin role sa më të rëndësishme për mirëmbajtjen e trashëgimisë së komuniteteve të veta dhe të planifikimit të së ardhmes. Plani bën ftesë për veprime të bashkërenduara mes të gjitha palëve përmes aktivizimit të grupeve lokale, palëve me interes dhe komuniteteve për t'u angazhuar drejtpërdrejtë në trashëgimi, dhe për t'i përdorur mjetet teknike qofshin ato shoqërore, ashtu edhe ekonomike për të siguruar mbrojtjen e saj. Qëllim tjetër i Planit nuk është vetëm bartja e trashëgimisë tek gjeneratat e ardhshme, por edhe e mjeteve me anë të së cilave do të mund të vazhdohet mbrojtja dhe mirëmbajtja e tyre.

Përmes Planit të trashëgimisë për Kosovën perëndimore eksplorohehen mënyrat për të ndërmjetësuar mes nivelit lokal dhe atij global. Ky është një proces i bazuar në komunitet, që promovon përdorimin e përgjegjshëm të burimeve lokale dhe menaxhimin e tyre nga brenda. Duke qenë shembull në Kosovë, ai hapë rrugë për veprime të bashkërenduara në këmbimin e përvojave dhe mbledhjen e energjive dhe burimeve. Në këtë mënyrë, hartimi i këtij dokumenti ka qenë shumë domethënës për inkurajimin e pjesëmarrjes së gjerë në rajon. Shpresoj se ky dokument do të jetë precedent dhe nxitje brenda Kosovës për krijimin e një Plani të trashëgimisë për mbarë Kosovën si dokument-strategji që do të udhëhiqej sipas parimit nga poshtë lartë, por me inkurajimin dhe miratimin e të gjitha institucioneve dhe autoriteteve relevante.

Robert Palmer

Drejtor për qeverisje demokratike, kulturë dhe diversitet
Këshilli i Evropës
Strasburg

SHIJOJE JETËN!

Të gjithë ne që kemi vizituar panairin e punimeve artizanale në qendër të Pejës apo Çarshinë e Madhe të Gjakovës dhe që jemi mrekulluar nga njohuritë autentike të zanatlinjve, si dhe nga oferta e gjerë e ushqimeve tradicionale dhe e çajrave të malit, nuk kemi nevojë për ligjëratë mbi trashëgiminë kulturore dhe natyrore – sepse ne e kemi përjetuar atë në dritën e saj më të mirë: e bërë nga njerëzit dhe për njerëzit! Por fakti se organizohen panairë të tilla, nuk është vetëm çështje e traditës. Ky ishte gjithashtu rezultat konkret i një programi të përbashkët të përkrahjes për Promovimin e Diversitetit Kulturor në Kosovë (PDKK), i cili kryesisht u financua përmes Instrumentit për Paraaderim të Bashkimit Evropian dhe u implementua nga Këshilli i Evropës. Organizimet e qershorit 2012 në Pejë dhe Gjakovë kanë qenë pjesë e këtij programi – dhe kur njeriu harton parathënien për Planin e trashëgimisë për regjionin e Kosovës perëndimore, fjalët për trashëgiminë natyrore dhe trashëgiminë jomateriale në Kosovën perëndimore menjëherë marrin ngjyrat, format e madje edhe shijet e ... bimëve aromatike.

Kjo është arsyeja pse planet e tilla ideohen, hartohen, diskutohen dhe botohen – pra, për t'i sjellë në jetë dhe për t'i përjetuar ngjyrat dhe shijet. Apo thënë në mënyrë edhe më ambicioze – për të injektuar disa praktika të reja, tanimë të harruara që moti, apo për të rizbuluar disa vlera të vjetra, të sapoharruara dhe për t'i futur ato në jetën e përditshme të njerëzve. Ju mund ta quani këtë diversitet shumëkulturor, zhvillim të qëndrueshëm apo cilësi më e mirë e jetës; por çështja është se qytetarët gjithmonë përfitojnë nga jetësimi i ideve të mira. Ky plan është ideuar me qëllim që të bëhet një dokument udhëzues për t'ju mundësuar komuniteteve lokale ta shfrytëzojnë trashëgiminë natyrore dhe kulturore për zhvillimin lokal dhe për t'ua përmirësuar cilësinë e jetës së tyre. Duke vepruar kështu, vetëdijësimi për trashëgiminë tonë, duke përfshirë trashëgiminë jomateriale, bëhet shumë, shumë material; fillon të krijojë njohuri të reja, vende të reja pune, mundësi të reja biznesi dhe – mbi të gjitha – krijohen ide të reja në mesin e brezave të ri.

Nëse ekziston një vend ku tradita është e vjetër me shekuj, por është edhe e re me vite, atëherë ai vend do të ishte vendi ku në njërin prej shesheve të tij është ngritur NEWBORN-i. Unë sinqerisht besoj se ky Plan i trashëgimisë do t'i inkurajojë të gjitha palët me interes të dëshmojnë se mund të gjejnë mbështetje në të kaluarën e trashëguar dhe se janë shumë mirë të orientuar kah e ardhmja. Duke kuptuar këtë, ata të gjithë do të marrin pjesë në proces që nuk është vetëm një "pilot projekt" tjetër, por është një proces që mund të shërbejë si frymëzim për fluturime të tjera përgjatë territoreve të vështira të krizës sonë moderne. Pra, kjo është arsyeja e ekzistimit të planeve dhe miqve.

Samuel Žbogar

Udhëheqës i Zyrës së BE-së dhe

Përfaqësues Special i Bashkimit Evropian në Kosovë

HYRJE

Ne tentojmë të krijojmë bashkësitë, ku trashëgimia kulturore dhe natyrore, si dhe diversiteti i kulturave pranohet si thelbësor në zhvillimin e kushteve për lehtësimin e kohezionit social dhe zhvillimin ekonomik. Përfshirja e mirëfilltë e bashkësive në praktikat e tyre të jetës së përditshme, ku ata janë pjesëmarrës aktivë në proceset e vendimarrjes për zhvillimin ekonomik dhe shoqëror, është jetike në ofrimin e ndihmesës drejt qasjes ndaj çështjeve komplekse që ndërlidhen me të jetuarit e përbashkët. Përmes dialogut ndërkulturor, ne kemi mundësinë të krijojmë mirëkuptimin e nevojshëm të ndërsjellë për t'u ndërlidhur me një-tjetrin dhe për të ripërkufizuar marrëdhëniet tona. Ekzistenca jonë sot dhe perspektivat tona të ardhshme shpesh ndikohen nga e kaluara jonë dhe nga ajo çka trashëgojmë nga e kaluara.

Trashëgimia thjesht mund të përshkruhet si pasuri dhe resurse kulturore e natyrore, të cilat qytetërimet i trashëgojnë nga e kaluara – në nivel lokal trashëgimia është një ndërthurje e bashkësive, vendeve, rrëfimeve dhe peisazheve. Mënyra se si ne personalisht e perceptojmë trashëgiminë kryesisht varet nga moshja jonë – fëmijët kanë tendenca ta ndërlidhin trashëgiminë me çdo gjë që është e “vjetër” apo historike, të rriturit e ndërlidhin trashëgiminë me identitetin, ndërsa më të vjetërit kanë tendenca ta ndërlidhin trashëgiminë me të “kaluarën” dhe me “humbjen” e vlerave. Por në përgjithësi, popullata e të gjitha moshave pranojnë rëndësinë e trashëgimisë në nivel të caktuar.

Të kuptuarit e rëndësisë së trashëgimisë jo gjithmonë është edhe vlerësim dhe të kuptuar i trashëgimisë. Trashëgimia po ashtu ka kaluar nëpër shkatërrime; nganjëherë edhe me vetëdije, për arsye të ndërlikuara, apo pa vetëdije, duke u lënë në mëshirë të shkatërrimit, dezintegrimit dhe zhdukjes. Pranimi i vlerës së trashëgimisë së ndryshme, respektimi dhe vendosja e saj në vendin e merituar në histori, është proces sfidues por edhe emocional, nëse menaxhohet në mënyrë të përgjegjshme.

Plani i trashëgimisë për Kosovën perëndimore është një produkt i nismës regjionale të komunitetit, të komponentës për Zhvillimin lokal ekonomik të projektit të përbashkët të BE/KE- Përkrahja për Promovimin e Diversitetit Kulturor në Kosovë (PDKK). Përmes këtij Plani tentohet identifikimi i strategjive më të përshtatshme për avancimin e objektivave në kuadër të zhvillimit të komponentit të turizmit të qëndrueshëm të trashëgimisë brenda strategjisë së përgjithshme të turizmit për regjion.

Komponenta e Zhvillimit Ekonomik Lokal (ZhEL) i projektit PDKK është frymëzuar dhe është ngushtë i ndërlidhur me Pilot Projektin për Zhvillimin Lokal (PPZhL) të Programit regjional të Këshillit të Evropës për trashëgiminë kulturore dhe natyrore në Evropën Juglindore. Përdorja e projekti PDKK ka qenë më shumë i përqendruar në turizmin e trashëgimisë, përmes tij gjithmonë është tentuar të ruhen lidhjet me programin regjional me qëllim të plotësimit të përpjekjeve të bëra në vendet e rajonit.

Hartimi i Planit për trashëgiminë si ide është ndikuar nga shembulli i suksesshëm i modelit të Këshillit për Trashëgiminë e Irlandës, ku ekspertët e Këshillit për Trashëgimi të Irlandës kanë ndihmuar në formësimin e Planit për trashëgimi të Kosovës Perëndimore si dhe kanë mbështetur ngritjen e kapaciteteve të grupeve vendore të interesit në Kosovën Perëndimore. Plani për trashëgiminë ka dalë si rekomandim kryesor nga studimi i fizibilitetit, i përfunduar në fillim të vitit 2011, që ishte vazhdimësi e procesit të grumbullimit të të dhënave, i cili u për-

fundua në vitin 2010. Plani paraqet një vazhdimësi racionale dhe bashkërendim të veprimeve paraprake në fushën e trashëgimisë, të nxitura përmes studimit të fizibilitetit.

Gjatë studimit të fizibilitetit është përdorur një qasje sistematike dhe e strukturuar, duke përfshirë edhe procesin e vlerësimit të të dhënave, i cili është analizuar në mënyrë sistematike, duke u bazuar në përparësitë, dobësitë, mundësitë dhe rreziqet vendore lidhur me zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm të trashëgimisë në zonë. Pilot veprimet që u ndërmoren njëkohësisht në gjashtë komuna të regjionit kanë dhënë kontribut domethënës në zhvillimin e planit.

Rezultat i analizës së skenarëve të mundshme në kuadër të strategjisë ka qenë miratimi i qasjes së 'sektorëve të integruar', që përfshinë integrimin e zhvillimit të turizmit të trashëgimisë përmes zhvillimit të sektorit të përgjithshëm të turizmit në regjion.

Strategjia përqendrohet në vetëdijësim, arsim, trajnime dhe në veprime të sugjeruara lidhur me trashëgiminë kulturore dhe natyrore, si dhe trajtohen çështje praktike që përfshijnë ruajtjen e lokaliteteve, restaurimin, shënjëzimin, informata për trashëgiminë dhe çështjet e sigurisë së lokalitetit të trashëgimisë. E gjithë kjo bëhet përmes partneritetit të lehtësuar dhe procesit të bashkëpunimit, ku përfshihen të gjitha grupet e interesit nga niveli qendror, komunal, i bashkësisë, nga sektori i trashëgimisë dhe i turizmit, si dhe akterët e tjerë nga regjioni.

Plani i trashëgimisë përbëhet prej shtatë pjesëve: theksimi i thelbit të trashëgimisë që është në zemrën e jetës në bashkësi; dhënia e përshkrimit të shkurtër të trashëgimisë së Kosovës perëndimore; paraqitja e idesë për trashëgimi dhe për planin e trashëgimisë, dhe përshkrimi se si kjo trashëgimi është zhvilluar. Po ashtu, Plani pasqyron ndryshimin e qëndrimeve dhe qasjeve të palëve vendore me interes gjatë procesit, si dhe thekson konsideratën strategjike në proceset zhvillimore. Dhe në fund, përcakton objektivat dhe veprimet e ndërlidhura e të arritshme, me një plan të qartë për mënyrën e zbatimit të planit.

Projekti i PDKK-së tenton të theksojë lidhjen organike mes trashëgimisë dhe diversitetit, e cila manifestohet përmes minimizimit të ndarjes mes trashëgimisë së prekshme dhe të paprekshme (jomateriale) kulturore dhe natyrore përmes një qasje tërësore, pjesëmarrëse dhe të integruar, ku të gjitha bashkësitë u dëgjohej zëri dhe kanë vendin e tyre. Kjo është thelbësore për përfshirjen sociale dhe për zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik.

Në kuadër të projekti PDKK, ne mendojmë se Plani i trashëgimisë do të mund të kishte ndikim të konsiderueshëm në zhvillimin lokal të Kosovës perëndimore dhe do të mund të paraqiste shembull pozitiv për regjionet e tjera të Kosovës, si dhe për pjesëmarrësit e Pilot Projektit për Zhvillimi Lokal të programit regional.

Hakan Shearer Demir

Udhëheqës i ekipit të PDKK-së

Terry O'Regan

Ekspert nga Këshilli i Evropës

FALËNDERIMET

Dëshirojmë t'i shprehim falënderimet tona të gjitha palëve që kanë marrë pjesë aktive në hartimin e këtij Plani, në veçanti:

- Pjesëtarët e bashkësive të gjashtë komunave
- Vullnetarët e bashkësisë
- OJQ-ët: 'Arteza', 'Podguri', 'Ballkan Promotion', 'Zana', 'Marimangat e Pejës', 'Intersos', 'CHWB', '7 Shtatori'
- Grupet punuese komunale të Pejës, Klinës, Deçanit, Istogut, Junikut dhe Gjakovës
- Qendrën për Trashëgiminë Kulturore (QTK) në Pejë
- Qendrën për Trashëgiminë Kulturore (QTK) në Gjakovë
- Anëtarët e Grupit punues regjional
- Kryetarët e komunës së Pejës, Klinës, Deçanit, Istogut, Junikut dhe Gjakovës
- Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit – Pikën kontaktuese të Pilot Projektit për Zhvillim Lokal

Ekipit të ekspertëve që ka kontribuar në hartimin e planit gjatë fazave të ndryshme:

- Julija Trichkovska, eksperte e lartë e PDKK-ës në fushën e trashëgimisë kulturore
- Terry O'Regan, Irlandë, ekspert i KE-së
- Liam Scott, Këshilli për Trashëgimi i Irlandës
- Bob Charmbury – konsulent i pavarur për zhvillim ekonomik
- Zekë Çeku, konsulent i pavarur për zhvillim të turizmit
- Burbuqe Deva, përfaqësuese e MKRS
- Valmira Gashi, eksperte nga MMPH
- Arsim Mulhaxha, QTK Pejë
- Vergina Dyla, QTK Gjakovë
- Jeton Aliu – Ministria e Tregëtisë dhe Industrisë – sektori i turizmit.

Organizatat partnere që kanë përkrahur procesin e ngritjes së kapaciteteve

- Këshilli për Trashëgimi i Irlandës, Irlandë;
- Parku Regjional Natyror i Vosges du Nord, Francë

Ekipit të Zhvillimit Lokal Ekonomik, PDKK

- Harmonije Radoniqi
- Nermin Kastrati

LISTA E SHKURTESAVE

BIOFOR-IQC	Kontratë e përhershme e cilësisë për biodiversitet dhe pylltari
QTK	Qendrat për Trashëgimi Kulturor
LTK	Ligji për Trashëgiminë Kulturor
CHwB	Trashëgimia Kulturor pa Kufi
KE	Këshilli i Evropës
SKIR	Studimet Krahimore për Integrimin Regjional
OShC	Organizatë e Shoqërisë Civile
PE	Partneritet Evropian
PVPE	Plan i Veprimit për Partneritet Evropian
GPM	Grup Përgjegjës Mjedisor
EU	Bashkim Evropian
Programi BE CARDS	Asistencë e Komunitetit të Bashkimit Evropian për Rindërtim, Zhvillim dhe Stabilizim
BPV	Bruto Prodhim Vendor
GIZ	Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit
PPZhL	Pilot Projekti për Zhvillim Lokal
LPH	Ligji për Planifikimin Hapësinor
MBZhr	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
MKRS	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
MAShT	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
MAPL	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
MTI	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (Departamenti i turizmit)
MTT	Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit
OJQ	Organizatë Joqeveritare
PDKK	Promovimi i Diversitetit Kulturor në Kosovë
GPR	Grup Punues Regjional
KOS	Kisha Ortodokse Sërbe
UNESCO	Organizatë e Kombeve të Bashkuara për Arsim, Shkencë dhe Kulturë
USAID	Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar



“Plani i trashëgimisë shënjon rrugën për rilidhje, ribashkim dhe pajtim mes njerëzve, tokës së tyre dhe trashëgimisë. Plani arrin deri te diaspora e gjerë e çdo komune me qëllim të hartimit të rrëfimit të përbashkët të urtësisë, të kuptuarit dhe të përparimit, duke ua dhënë kështu të gjithë qytetarëve një proces dinamik për përhapjen e këtij rrëfimi me fqinjët dhe mysafirët e tyre.”

Trashëgimia në thelb të jetës në bashkësi



1.1 Trashëgimia

Trashëgimia është çdo gjë që kemi trashëguar nga e kaluara, duke përfshirë monumentet, objektet arkeologjike dhe objektet tjera të trashëgimisë, trashëgiminë arkitektural, florën, faunën, habitatet e kafshëve të egra, peizazhet, gjeologjinë, kopshtet dhe parqet e trashëgimisë, rrjedhat e lumenjve, gjenealogjinë, folklorin, gojëdhënat dhe historinë e vendit.

Trashëgimia është pjesë kryesore e identitetit tonë dhe e ndjenjës për vend. Është pjesë e pandashme e jetës sonë të përditshme, një burim i madh i punësimit, rekreacionit, shëndetit, të mësuarit dhe argëtimit. Vlera shoqërore e trashëgimisë është e pamatshme nga aspekti i angazhimit të bashkësisë, i krenarisë me karakterin e dukjes së rrugëve dhe të peizazheve dhe i nevojës për kujdes ndaj mjedisit tonë.

Ekziston një arsyetim i shëndoshë ekonomik në përkrahjen e trashëgimisë, ku turizmi i trashëgimisë ka rol kyç në ekonominë në zhvillim. Turizmi i trashëgimisë është burim punësimi dhe i të hyrave të qëndrueshme financiare kur përdoret si pjesë e programit gjithëpërfshirës zhvillimor.

Trashëgimia përfshinë elementet e prekshme dhe të paprekshme (jomateriale) që pasqyrojnë kulturën dhe kreativitetin e bashkësive njerëzore që nga kohërat më të lashta, si dhe diversitetin e pasur e bukurinë e trashëgimisë natyrore.

1.2 Vlera e trashëgimisë

Në të kaluarën trashëgimia shpesh është perceptuar gabimisht si një përgjegjësi vetëm e qeverive dhe e akademikëve. Por, ashtu siç ekziston pronësia qendrore ndaj trashëgimisë, ashtu ekziston edhe pronësia nga ana e bashkësisë, e madje edhe pronësia personale e trashëgimisë. Shumica e familjeve kanë trashëgimi të pasur familjare përmes mobileve, dekorimeve, librave dhe dokumenteve, përrallave, këngëve, historisë dhe madje edhe veshjeve që janë bartur brez pas brezi. Trashëgimia është element bazë i programeve arsimore në mbarë botën. Andaj, ajo njihet nga të gjitha nivelet e shoqërisë si një gjë me vlerë që jo gjithmonë mund të matet nga aspekti monetar.

Pronësia komplekse dhe dimensionet e vlerës së trashëgimisë mund të shpjegojnë se pse e njëjta aq shpesh kërcënohet. Vlerat e saj simbolike mund të rezultojnë në shkatërrim të qëllimshëm gjatë luftërave apo gjendjeve të konfliktit. Mungesa e perceptuar e vlerës monetare të saj, mund të rezultojë në shkatërrimin e saj për shkak të keqinformimit apo në vetrrënim, posaçërisht kur rëndësia e saj nuk është njohur, hulumtuar, identifikuar dhe mbrojtur zyrtarisht nga ndërhijet e ndryshme dhe nga dëmtimi prej kushteve atmosferike. Vetëdijesimi për këto kërcënime ndaj trashëgimisë duhet të përfshihet në çdo strategji që ka për qëllim vendosjen e trashëgimisë në thelb të sistemit të vlerave të të gjitha shoqërive. Reagimi ndaj këtyre kërcënimeve dhe realizimi i vlerës maksimale të trashëgimisë për të gjithë qytetarët kërkon financim të duhur dhe qasje të nduarnduarshme për gjetjen dhe arsyetimin e fondeve të nevojshme.

Rrjedhimisht, është një fatmirësi që në mbarë botën sot trashëgimia e përbashkët ka vlerë të rëndësishme ekonomike në nivel qendror, komunal dhe të bashkësisë si një atraksion për turistë dhe, gjithnjë e më shumë, edhe për investitorë. Shumica e shteteve, në mos të gjitha, kanë vendet e tyre të trashëgimisë të rëndësishme botërore, por zakonisht këto vende janë të pakta në numër dhe përderisa rëndësia e tyre garanton ardhjen e turistëve, ato zakonisht kanë kufizime të natyrës së kapaciteteve, dhe ato si të vetme rrallë ofrojnë bazën për një sektor të qëndrueshëm dhe të realizueshëm të turizmit të trashëgimisë. Andaj, të gjitha bashkësitë përparimtare dhe të përgjegjshme kanë stimulim të fortë për t'u angazhuar në mënyrë proaktive dhe kreative në kuadër të trashëgimisë së tyre më të gjerë.

Ndërmarrja e veprimeve në fushën e trashëgimisë përfshinë identifikimin e vlerës së saj shoqërore, kulturore dhe ekonomike. Përmes pesë hapave bazë, bashkësitë:

- Mund të identifikojnë dhe regjistrojnë trashëgiminë e tyre;
- Mund të garantojnë që ajo të ruhet;
- Mund ta integrojnë në kulturën e sotme të jetesës;
- Mund t'ia caktojnë një shfrytëzim të qëndrueshëm, aty ku është e mundur;
- Mund të respektojnë dhe pranojnë përgjegjësinë që ta bartin trashëgiminë e tyre të padëmtuar tek brezat e ardhshëm.

Kjo kërkon një qasje strategjike dhe të strukturuar në nivel qendror, regjional, komunal dhe të bashkësisë, dhe është më e suksesshme dhe e qëndrueshme kur bazohet në bashkësitë vendore, të cilat e ndajnë trashëgiminë e tyre të vlefshme me vizitorët, dhe nuk e shfrytëzojnë atë vetëm në baza komerciale, duke eksploatuar burimin e trashëgimisë kulturore si një burim të produktit turistik.

Qasja e Planit të trashëgimisë paraqet një kornizë strategjike sa praktike, aq edhe të qëndrueshme, për lehtësimin dhe bashkërendimin e pesë veprimeve kyçe, të identifikuar më lartë, me qëllim të realizimit të vlerës së plotë të trashëgimisë së përbashkët për shoqërinë.

1.3 Çka është Plani i trashëgimisë?

Plani i trashëgimisë është strategji për identifikimin, mbrojtjen, ruajtjen, përmirësimin, interpretimin dhe menaxhimin e qëndrueshëm të trashëgimisë, i cili zbatohet në nivel qendror, regjional dhe komunal. Ky Plan paraqet një plan veprimi të pajtuar dhe real, i cili i referohet mekanizmave të ofrimit dhe kërkesave buxhetore. Në nivele të ndryshme, mund të ndërmerren veprime nga një grup apo organ ose nga një numër grupesh në partneritet. Në nivel të regjionit, plani i trashëgimisë mund ta merr formën e një plani strategjik regjional, i cili përcillet nga një numër planesh komunale. Cilado që të jetë shkalla e planit, aty duhet të identifikohen

**MUZEU ETNOGRAFIK,
KOMUNA E GJAKOVËS**
Ekspozita e Muzeut etnografik është hapur në njërin prej objekteve më karakteristike tradicionale në Gjakovë, të ndërtuar në vitin 1810. Si një monument i ruajtur mirë, me një koleksion të pasur të artfakteve, është një destinacion atraktiv për turistë.
Ka nevojë për materiale të duhura promovuese për ekspozitën, si dhe për vetë monumentin.

prioritetet për veprimet e të gjitha palëve me interes për një periudhë trevjeçare, si dhe duhet të përfshihet mekanizmi për shqyrtim e vlerësim.

Plani i trashëgimisë paraqet mundësinë e identifikimit të çështjeve dhe nevojave të trashëgimisë në nivel qendror, regional dhe komunal, si dhe të trajtimit të tyre në nivelin lokal. Plani ka për qëllim stimulimin e veprimeve të të gjithë akterëve kryesorë të përfshirë në fushën e trashëgimisë, si dhe të ngritë vetëdijen për atë trashëgimi dhe vlerën e potencialin e saj. Andaj, ky Plan është edhe dokument strategjik për atë se çka dëshirojnë të arrijnë qytetarët lidhur me menaxhimin dhe ruajtjen e trashëgimisë gjatë tri viteve të ardhshme, e njëkohësisht është një listë veprimesh që duhet të ndërmerren për arritjen e qëllimeve dhe objektivave strategjike.

1.4 Pse të kemi një Plan trashëgimie?

Ruajtja dhe menaxhimi i trashëgimisë është përgjegjësi jo vetëm e pushtetit qendror dhe komunave, por edhe e të gjithëve brenda komunitetit. Shpesh më së miri funksionon kur bëhet në partneritet, duke përfshirë të gjitha grupet dhe individët e interesuar. Plani i trashëgimisë është mënyrë e efektshme për arritjen e konsensusit për mënyrën më të mirë të ruajtjes dhe të menaxhimit të trashëgimisë në mënyrë bashkëpunuese përmes fokusimit në një vistër energjish dhe nismash të përbashkëta për të mirën e asaj trashëgimie dhe të bashkësive pjesëmarrëse. Ky është një mekanizëm bashkërendues që jep kontekstin strategjik të veprimeve të përbashkëta, për të siguruar dhënien e përparësive më të mëdha për trashëgiminë në fjalë.

Përpyekjet dhe nismat e grupeve lokale dhe të autoriteteve qendrore mund të gjejnë kontekst më të gjerë përbrenda Planit të trashëgimisë dhe të lehtësojnë arritjen e marrëveshjes rreth identifikimit të prioriteteve për shpërndarjen e fondeve në dispozicion për ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë.

1.5 Për kë është i paraparë Plani i trashëgimisë?

Plani i trashëgimisë është i paraparë për njerëz, për të gjitha agjencitë dhe grupet relevante të regjionit, si dhe për komunitat. Ky plan bazohet në parimin e ndarjes së përgjegjësisë për trashëgiminë dhe të pronësisë ndaj saj.

1.6 Cili është qëllimi i Planit të trashëgimisë?

Përmes Planit të trashëgimisë tentohet të sigurohen benifite për bashkësinë e atij vendi përmes vetëdijësimit, vlerësimit, shfrytëzimit të saj të qëndrueshëm, qoftë ekonomik apo të natyrës tjetër të trashëgimisë së saj të pasur kulturore dhe natyrore. Plani po ashtu mund të përdoret për të fituar përkrahjen e akterëve kyçë dhe për farkimin e partneriteteve të reja në ruajtjen, vetëdijësimin dhe paraqitjen e trashëgimisë. Përmes Planit u mundësohet akterëve të ndryshëm që të përfshihen në diskursin e rëndësisë së trashëgimisë në kuptim të vlerave të saj globale, kulturore, arsimore, akademike, ekonomike, rekreative, estetike dhe personale, përveç vlerave të veta të brendshme që i ka. Plani po ashtu njeh vlerën e këmbimit të informatave dhe të përgjegjësisë lidhur me trashëgiminë.

Plani i trashëgimisë bazohet në qasje të integruar ndaj identifikimit, mbrojtjes, ruajtjes, menaxhimit dhe prezantimit të pasurive të trashëgimisë. Në këtë vazhde, përmes Planit duhet të tentohet përfshirja e aspekteve të ndryshme të asaj trashëgimie, duke e shikuar mjedisin historik, natyror, kulturor, shoqëror dhe ekonomik si tërësi, e jo duke i trajtuar ato veç e veç. Ky është koncepti i ri i trashëgimisë.

1.7 Si është i mishëruar koncepti i trashëgimisë në Planin e trashëgimisë?

Plani i trashëgimisë është një mundësi për ta njohur dhe pranuar prezencën e trashëgimisë përrreth nesh, e jo ta konsiderojmë atë si diçka që vizitohet vetëm gjatë pushimeve apo fundjavave.



Bajrakli xhamia, Pejë

Në paraqitjen e një koncepti të filltë, Plani për trashëgimi duhet të trajtojë mjedisin si tërësi, e jo vetëm të tentojë mbrojtjen e trashëgimisë më të mirë apo më të dukshme.

Legjislacioni, financimi dhe përpjekjet administrative të sotme kanë pasur tendenca të përqendrohen në mbrojtjen vetëm të aspekteve dhe shembujve më të 'rëndësishëm' dhe domethënës të trashëgimisë. Derisa rëndësia e këtyre lokaliteteve, strukturave dhe llojeve e arsyeton mbrojtjen e tyre të kujdesshme, Plani për trashëgimi gjithashtu njih trashëgiminë edhe jashtë këtyre zonave të përcaktuara. Në Plan përfshihet ndikimi i të kaluarës dhe i njerëzve të saj në çdo aspekt të peisazhit, i dukshëm për nga pamja dhe morfologjia e saj. Shpesh kemi të bëjmë me një pjesë peisazh të pacaktuar apo të rëndomtë që ofron kontekst për lokalitete dhe struktura të rëndësishme dhe të përcaktuara, si nga aspekti i hapësirës, ashtu edhe i domethënies që ato kanë, dhe në këtë mënyrë mundësojnë që ato të kuptohen më plotësisht. Një koncept i filltë i trashëgimisë është më i afërt me parimet e zhvillimit të qëndrueshëm, dhe përfaqëson një kuptueshmëri të gjerë të trashëgimisë, duke e bërë atë më relevante për jetën tonë moderne. Po ashtu, ky koncept mundëson një kuptueshmëri më koherente të mjedisit, të ndërveprimit mes aspekteve të ndryshme të trashëgimisë dhe një pjesëmarrje më të madhe të qytetarëve në debatin lidhur me atë se çka është e rëndësishme, çka duhet të mbrohet dhe si duhet paraqitur para vizitorëve lokalë, më gjerë nga shteti dhe vizitorët e huaj. Një qasje e filltë tërësore ngërthen në vete një vistër më të gjerë të vlerave për t'i futur në debat.

1.8 Çka përmban Plani i trashëgimisë?

Përmes Planit të trashëgimisë shqyrtohen veprimet, të cilat mund të jenë ndërmarrë dhe përcaktohet lista e veprimeve të ardhshme, që pritet të ndërmerren nga një numër entitetesh gjatë periudhës së ardhshme trevjeçare të përfshirë në plan. Aty përfshihet një listë e objektivave të gjëra strategjike, të cilat do të arrihen me ndihmën e atyre veprimeve. Për aq sa është e mundur, në Plan përcaktohet se kush do të kryej cilin veprim dhe afati i paraparë për çdo veprim. Në Plan mund të përcaktohen edhe burimet e financimit, por mund të mos përcaktohet kostoja për çdo veprim të propozuar.

Plani i trashëgimisë nuk përfshinë domosdo veprimet që janë specifike për objektin apo vendin a për stabilizimin e monumentit të caktuar. Në përgjithësi, Plani për trashëgiminë përmban veprimet që pasqyrojnë prioritetet e identifikuara lidhur me grumbullimin e të dhënave, vetëdijesimin, promovimin e praktikave më të mira dhe prezantimin e tyre.

1.9 Trashëgimia e qëndrueshme

Aspektet ekonomike të trashëgimisë janë shpatë me dy tehe. Mbrojtja, restaurimi dhe menaxhimi i trashëgimisë është një proces i shtrenjtë, dhe të pakta janë qeveritë në botë që kanë resurse të financojnë një punë kaq të rëndësishme, përveç nëse financimi nga qendra ndihmohet edhe me të hyrat e fituara përmes vet trashëgimisë. Nga aspekti ndërkombëtar, turizmi i trashëgimisë është bërë mekanizëm vital për gjenerimin e të hyrave aq të nevojshme të drejtpërdrejta dhe, që është më e rëndësishme, të tërthorta, për përkrahjen e sektorit të trashëgimisë.

Ekziston një treg i qëndrueshëm dhe i dëshmuar i turizmit për produktet e trashëgimisë të paraqitura profesionalisht dhe të menaxhuara në mënyrë të qëndrueshme. Në vendet në zhvillim, turizmi në shumë raste krijon mbi 20% të BPV-së së vendit, dhe është burimi kryesor i këmbimit të huaj për 49 vendet më së paku të zhvilluara në botë.

Në Irlandë, vend i vogël që në disa aspekte mund të krahasohet me Kosovën, 40% e shpenzimeve të turistëve i atribuohen mjedisit historik. Rreth 2.5 milionë njerëz në vit i vizitojnë shtëpitë dhe kalatë, dhe 2 milionë njerëz vizitojnë monumentet e saj. Të hyrat e krijuara përmes turizmit të trashëgimisë drejtpërsëdrejti vijnë përmes pagesës për hyrje në këto vende dhe nga shitjet e tjera të mallrave përreth, por dobia e vërtetë ekonomike del indirekt nga shpenzimet në ushqim, akomodim dhe në shërbimet e tjera.

Duhet të theksohet se turizmi i qëndrueshëm – kur atraksioni turistik menaxhohet dhe mbrohet, derisa vlera e tij realizohet në mënyrë të përgjegjshme – kërkon një qasje të planifikuar që nga fillimi i zhvillimit të produktit të trashëgimisë. Duhet të pranohet se turizmi i trashëgimisë ngritë amortizimin e resursit të trashëgimisë dhe ngritë nivelin e mirëmbajtjes dhe kujdesit të nevojshëm.

Po ashtu, është thelbësore të ceket se sektori i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme të biznesit ka qenë shtyllë mbajtëse e ekonomisë evropiane, dhe është i mishëruar në qasjen e këtij Plani. Përderisa korporatat e mëdha kanë tendencë të shfrytëzimit përzgjedhës dhe intensiv të lokaliteteve kryesore të trashëgimisë në dëm të zhvillimit të bashkësisë së gjerë, sektori i NMV-ve lulëzon në mjedisin e turizmit të trashëgimisë dhe është më i qëndrueshëm në nivel lokal.


PUNIMI TRADICIONAL I DJEPAVE, KOMUNA E GJAKOVËS

Djepi është një nga produktet karakteristike të zdruktharëve të Gjakovës. Prodhimi i tij përbehet prej një procesi të gjatë që fillon me blerjen e lëndës së parë – drurit të ahut dhe të bredhit që në të kaluarën janë prerë në bjeshkët e regjionit. Pas montimit dhe ngjitjes së elementeve të drurit, djepi ngjyroset. Dekorimi përbehet prej 12 ngjyrave, ku e kuqja e mbyllët mbizotëron. Dekorimi i fundit me lule është trashëguar nga çdo familje artizanale.

Zeja dhe të gjitha ritualet e ndërlydhura me këtë proces janë në rrezik të zhdukjes sepse vetëm dy familje ende merren me këtë zeje në Gjakovë. Çdo javë punohen tre apo katër djepa, ndërsa blerësit kryesisht vijnë nga fshatrat e regjionit të Hasit. Ka nevojë urgjente për hartimin e planit për ruajtjen e këtij artizanati dhe për gjetjen e zgjidhjeve për këtë problem; për shembull, kjo zeje do të mund të modifikohet për qëllime të turizmit.



Trashëgimia e Kosovës perëndimore



Trashëgimia në pjesën perëndimore të Kosovës – një territor i ndarë administrativisht në gjashtë komuna: Pejë, Gjakovë, Klinë, Deçan, Istog dhe Junik – është dëshmi e historisë së pasur dhe komplekse, si dhe e diversitetit të formave të peisazheve që kanë krijuar topografinë specifike të regjionit.

Trashëgimia kulturore e qendrave kryesore ekonomike të Pejës dhe Gjakovës paraqet zhvillim dinamik historik, i cili është ndikuar nga lidhja mes koncepteve urbane dhe planeve arkitektonike të qendrave orientale tregtare (qarshive) brenda Perandorisë Osmane. Strukturat e ruajtura të qarshive në këto dy qytete hedhin dritë në jetën specifike të brezave të zanatlinjve dhe të myshterinjve që vinin nga pjesë të ndryshme të regjionit.

Punët e gjata dhe të efektshme të restaurimit në njërin prej qarshive më të mëdha osmane në Ballkan të asaj kohe – Çarshia e Madhe e Gjakovës – ringjallen traditat e ndërtimit të një numri të objekteve: nga ato fetare (Xhamia e Hadumit), në dyqane të vogla të drurit, në objekte karakteristike për bujtina dhe freskim (siç është Hani i Haraçisë dhe Teqja e Sheh Eminit), e deri te objektet e banimit (shtëpia e familjes Sina, tani Muzeu Etnografik) dhe në disa ura përgjatë lumit Erenik (Ura e Terzive, Ura e Tabakëve dhe Ura e Taliqit).

Edhe pse shumica e strukturave që përbëjnë bërthamën e Çarshisë së Pejës nuk janë ruajtur, ato që kanë mbijetuar dhe janë restauruar njihen si monumente historike të rëndësishme të lartë. Këtu përfshihen Bajrakli Xhamia, Hamami i Haxhi Beut, Shtëpia e Tahir Beut (tani Muzeu Etnografik) dhe shtëpitë e familjes Goska, të Zenel Beut dhe të Qamil Limanit. Në zhvillimin e jetës shoqërore dhe ekonomike – dhe rrjedhimisht, të karakteristikave urbane dhe arkitektonike – të Pejës në pjesën e dytë të shekullit 19-të, ka ndikuar edhe Haxhi Zeka (qytetar i Pejës), i cili dha tokën për ndërtimin e shkollës së parë fillore në qytet dhe për ndërtimin e njërit prej mullinjve më të mëdhenj në zonë.



Një nga llojet e veçanta të objekteve të trashëgimisë në këtë zonë është kulla. Varësisht prej mjeteve financiare të pronarëve të saj, këto kulla të fortifikuara të gurit mund të jenë prej dy deri në katër kate të larta, dhe gjenden në vendet urbane e po ashtu edhe në ato rurale. Rregullimi i brendshëm pasqyron mënyrën e jetesës së bashkësisë, ku roli i meshkujve të saj ka qenë dominant. Në atë kontekst dhoma ku vetëm burrat kanë mundur të rrinë (oda) është shfrytëzuar për mbledhi lidhur me çështjet e rëndësishme familjare apo të bashkësisë, si dhe për pritjen e mysafirëve. Zakonisht oda është hapësira më e madhe brendshme, e cila është e dekoruar me skalitje druri, tapiceri dhe me ornamente të tjera. Shpesh oda mund të dallohet edhe nga jashtë përmes pjesëve të shkallëzuara apo të punuara me gur. Këto tipare të banimit gjenden në të gjashtë komunat, por ato më të ruajturat kryesisht gjenden në qendrat e vendbanimeve kryesore. Në komunën e Deçanit, kemi kullat e Kuklecve, Osdautajve, Mazrekajve, Zymer Himës dhe të familjes Demukaj; në Junik kemi kullën e familjes së Jah Ymerit; në Istog, të familjes së Qerim Rugovës; në Klinë kemi kullën e familjes së Mark Jakajt, si dhe ato tanimë të cekura në Gjakovë e Pejë.

Jeta e pasur shoqërore e popullsisë, e përqendruar në çarshi, por edhe në shtëpi, gjithashtu shprehet përmes festave të shumta, organizimeve tradicionale dhe me punëdore unike, të cilat vazhdojnë edhe sot e kësaj dite. Në kuadër të njohjes dhe promovimit të kësaj 'trashëgimie jomateriale (të gjallë)', janë identifikuar shumë elemente karakteristike, njerëz, grupe dhe individë përmes organizimeve dhe aktiviteteve të ndryshme. Këtu përfshihen "Lojërat e Rugovës" – një shfaqje kjo e shkathtësive të pjesëmarrësve, si dhe punimi i plisave që është njëri prej zanateve të

MULLIRI I QELË SHABAN BICAJT AFËR FSHATIT VRELLË, KOMUNA E ISTOGUT

Mulliri i Qelë Bicajt është pjesë e kompleksit të mullirit të Vrellës. Ky është një mulli treqind vjeçar me ujë, i cili punon edhe sot e kësaj dite. Mulliri gjendet në kreshtën nën burimin e Vrellës dhe ka ujë gjatë tërë vitit.

Për shkak të funksionimit aktiv të mullirit, rekomandohet hartimi i planit të rehabilitimit dhe menaxhimit.



Veshje kombëtare serbe



Djepa, punëdore



Kulla e Mushkolajve, Deçan

pakta që kanë mbetur në komunën e Pejës; tradita familjare e tjerrjes dhe e punimit të lidhëseve e mërhamave, si dhe tradita e qethjes së deleve në Deçan; e zanatlinjve që ende punojnë dhe dekorojnë djepet e drurit (siç është rasti në Çarshinë e Madhe të Gjakovës); festimeve tradicionale familjare në komunën e Istogut për shënimin e fundit të stinës së korrje-shirjeve në tetor; punimit të veshjeve tradicionale të grave në komunën e Klinës dhe e garave shumë të popullarizuara të kuajve që janë mbajtur në Junik.

Dy komplekset e famshme të manastireve, Patriarkana e Pejës dhe Manastiri i Deçanit, gjithashtu luajnë role të rëndësishme në historinë e regjionit. Ato përfaqësojnë periudhën e gjatë të pranisë së Kishës Ortodokse Serbe dhe rëndësinë e saj në ruajtjen e fesë ortodokse gjatë kohërave turbulente të Perandorisë Osmane. Vlerat artistike të arkitekturës dhe ikonat e shekujve 13-19, pasqyrojnë të arriturat e mëdha të kulturës mesjetare të Bizantit dhe të asaj serbe, si dhe ndikimin e artit fetar të Evropës Perëndimore, të cilat janë pranuar në nivel ndërkombëtar nga UNESCO-ja. Duke marrë parasysh rëndësinë historike dhe vlerat artistike të këtyre objekteve në kontekstin e rrethanave specifike politike në regjion, këto vende janë regjistruar në Listën e UNESCO-s të vendeve të trashëgimisë botërore në rrezik në vitin 2004-2006.

Një begati e lumenjve dhe e rrafshëltartave, përrenjve dhe e kodrinave, nën bjeshkët e larta, kombinohen në forma specifike të relievit që ofrojnë mundësi të shumta për zhvillimin e turizmit dhe për përfitime ekonomike. Gjithashtu, këtu përfshihen: burimi, shpellat dhe gryka e lumit Drini i Bardhë, i cili kalon nëpër komunën e Pejës, Gjakovës dhe Deçanit; Ujëvara e Mirushës në Klinë, liqenet e Gjeravicës (Junik) dhe ai i Radoniqit (Gjakovë); Parku i Shkugëzës (afër Gjakovës); banja termale në Istog; burimet piktoreske të lumit Erenik (në bjeshkët përreth Junikut); dhe bjeshkët e Rugovës me grykën dhe shpellat e saj mahnitëse. Këta janë vetëm disa shembuj në mesin e shumë syresh të bukurive të mëdha natyrore në këto gjashtë komuna, të cilat ende nuk janë zbuluar nga qytetarët. Ato paraqesin një resurs të pashtershëm, me një potencial zhvillimor të kombinuar të trashëgimisë natyrore dhe turizmit kulturor të trashëgimisë në regjion.



Hartimi i Planit të trashëgimisë për Kosovën Perëndimore



3.1 Drejt Planit për trashëgimi – Hulumtimi dhe vlerësimi

Plani për trashëgimi është zhvilluar si produkt i komponentës së projektit të PDKK-ës, Pilot Projekti për Zhvillim Lokal në Kosovën Perëndimore. Ky Plan fokusohet në zhvillimin e turizmit të trashëgimisë, duke i sintetizuar së bashku në mënyrë të efektshme të gjitha aktivitetet e pilot projekteve në një strategji të integruar për regjionin, duke përfshirë edhe aktivitetet e përfunduara dhe ato që janë propozuar tani për tri vitet e ardhshme.


Lidhur me metodologjinë, pilot projekti fillimisht është strukturuar në pesë faza:

1. Faza e diagnozës
2. Studimi i fizibilitetit
3. Veprimet testuese
4. Draft strategjia regjionale për zhvillimin e turizmit
5. Themelimi i Mekanizmit Monitorues Regjional për Planin e Trashëgimisë dhe Menaxhim

Projekti ka përparuar në bazë të dinamikave në regjion, ku përqendrimi në fazat e mëvonshme specifikisht ka qenë në trashëgiminë kulturore dhe natyrore, si dhe në potencialin e saj turistik.

Gjatë tërë këtij procesi, si prioritet është trajtuar angazhimi i bashkësive në trashëgiminë e tyre të përbashkët përmes vetëdijësimit, promovimit, edukimit dhe aktiviteteve për ngritjen e kapaciteteve.

Rrjedha e punës është paraparë të jetë si në vijim:



Faza fillestare e vlerësimit të gjendjes kryesisht ka përfshirë një anketë të gjerë, të realizuar nga UBO Consulting në vitin 2010. Përmes kësaj ankete është krijuar një bazë gjithëpërfshirëse e të dhënave për të gjitha aspektet lidhur me mundësitë e zhvillimit të turizmit të trashëgimisë në regjionin e Pejës.

Përmes studimit të fizibilitetit, të realizuar në vitin 2011, janë vlerësuar të dhënat e grumbulluara, si dhe janë identifikuar strategjitë dhe opsionet për realizimin e qëndrueshëm të vlerës së trashëgimisë së pasur kulturore të regjionit nga aspekti shoqëror, kulturor, arsimor dhe ekonomik.

Njëkohësisht me fazat e tjera, janë ndërmarrë veprime testuese me qëllim të marrjes së informatave për procesin dhe të përfshirjes aktive të bashkësive të regjionit në proces.

Ky Plan i trashëgimisë në të njëjtën kohë paraqet një kornizë praktike dhe të qëndrueshme që bazohet në punën e kryer deri më tani, si dhe mbështet zbatimin e veprimeve të identifikuara si të dëshirueshme gjatë studimit fizibilitetit.

3.2 Drejt Planit të trashëgimisë – Udhëzimet dhe puna në teren

Nga përvoja e fituar në kuadër të veprimeve të para, të filluara në vitin 2010, gjatë dizajnit të studimit fizibilitetit, ekipi i projektit të PDKK-së konsideroi se kishte nevojë të ndërmerren disa veprime të reja me qëllim të trajtimit të kapaciteteve të trashëgimisë dhe të mjedisit të saj në kontekstin më të gjerë të planifikimit strategjik. OJQ-të vendore në vitin 2011 kanë ndërmarrë veprime lidhur me inventarizimin më gjithëpërfshirës të trashëgimisë, ku kanë kontribuar Qendrat për trashëgimi kulturore të Pejës dhe Gjakovës në përputhje me kriteret e ofruara nga ekipi i projektit të PDKK-së.

Në përzgjedhjen e lokaliteteve të trashëgimisë dhe të aseteve për

PUNIMI I PLISAVE, KOMUNA E PEJËS
Plisi është pjesë e veshjes kombëtare të burrave, i cili dallon në rajon për nga forma dhe ngjyra e tij e bardhë. Punimi i plisit përbehet prej 16 fazave. Materiali më i mirë për punimin e plisit është leshi i deles merino. Punimi i plisave është zanat në rënje dhe i rrezikuar nga zhdukja. Njëri prej plisëpunuesve të pakët të mbetur ende punon në Çarshinë e Vjetër të Pejës. Vullneti i tij për të vazhduar punën në këtë zanat duhet të përkrahet dhe të zhvillohet, ndërsa shkathtësia dhe njohuria e tij duhet të demonstrohet dhe regjistrohet.

pilot projektet, janë marrë parasysh të gjitha lokalitetet e trashëgimisë dhe të diversitetit në regjion si atraksione të mundshme që do të mund të nxisin zhvillimin e 'nënsektorëve të turizmit alternativ', p.sh.: turizmin kulturor, shpirtëror apo ekologjik. Kriteri për përzgjedhjen e peisazheve natyrore e kulturore dhe të monumenteve historike, të lokaliteteve dhe traditave të gjalla është realizuar në bazë të vlerësimit të:

- Kushteve të asetit të trashëgimisë, gjegjësisht të paraqitjes së saj para publikut të gjerë;
- Qasjes së duhur në asetin e trashëgimisë;
- Disponueshmërinë e të dhënave të karakteristikave të vlerësuara të asetit të trashëgimisë;
- Kapacitetit infrastrukturor të mjedisit përreth.

Më poshtë janë paraqitur dobësitë e sektorëve të trashëgimisë të regjionit, të identifikuar përmes analizës SWOT, e cila ishte edhe veprimi kryesor në studimin e fizibilitetit:

TRASHËGIMIA E PALUAJTSHME KULTURORE:

- Informata të mangëta për vendet arkeologjike;
- Nuk ka shënjime të vendeve arkeologjike
- Nuk ka shenja të drejtimeve rrugore për zonat e trashëgimisë natyrore e kulturore
- Mungesa e regjistrimit të përditësuar dhe gjithëpërfshirës për trashëgiminë e ndërtuar dhe peizazhet kulturore
- Mungesa e qasjes së integruar ndaj trashëgimisë brenda planifikimit hapësinor
- Mungesa e programeve të menaxhimit dhe të rehabilitimit

TRASHËGIMIA E LUAJTSHME KULTURORE:

- Mungesa e regjistrimit gjithëpërfshirës të koleksioneve të muzeve
- Mungesa e materialeve promovuese
- Mungesa e qasjes sistematike në konservimin, ruajtjen, paraqitjen dhe interpretimin e koleksioneve të muzeve.

INSTRUMENTET DHE MJETET JURIDIKE PËR MBROJTJEN E TRASHËGIMISË:

- Ligjet: Ligji për trashëgiminë kulturore dhe Ligji për planifikimin hapësinor
- 7 rregullore të nxjerra sipas Ligjit për trashëgimi kulturore
- 7 udhëzime të nxjerra sipas Ligjit për trashëgimi kulturore

TRASHËGIMIA KULTURORE E PAPERKSHME (JOMATERIALE):

- Nuk është e regjistruar
- Mungojnë materialet promovuese të mënyrës tradicionale të jetesës së bashkësive
- Mungojnë organizimi i ngjarjeve dhe performancave
- Mungon përkrahja për zanatlinjtë tradicionalë, performancat apo për produktet e tjera të trashëgimisë kulturore të paprekshme

TRASHËGIMIA NATYRORE:

- Informata të pamjaftueshme për bukuritë dhe atraksionet natyrore
- Kushte joadekuate për konservim dhe qasje për qytetarët;
- Mungesa e një qasjeje të integruar kundrejt peisazheve gjatë planifikimit të zonave të trashëgimisë
- Mungesa e infrastrukturës



Qëndrimet dhe qasjet në ndryshim

Gjatë realizimit të projektit të PDKK-së, janë organizuar një numër aktivitete, me pjesëmarrje aktive të palëve vendore me interes. Po ashtu, është bërë vlerësimi preliminar për ndikimin e punës së projektit të PDKK-së, përmes të cilit u identifikuan qëndrimet dhe qasjet në ndryshim e sipër drejt zhvillimit lokal dhe trashëgimisë si rezultat i pjesëmarrjes në projekt. Sipas këtyre palëve vendore me interes, projekti PDKK ka kontribuar:

- Në rritjen e njohurive dhe përvojës të OJQ-ve lidhur me trashëgiminë kulturore dhe diversitetin;
- Në përmirësimin e marrëdhënieve dhe të bashkëpunimit mes OJQ-ve dhe institucioneve;
- Në ndryshimin e perceptimit të OJQ-ve dhe të bashkësisë së shpërblyer financiare janë arsyetuar më e rëndësishme për të punuar dhe për të qenë i angazhuar;
- Në rritjen e vetëdijësimit se puna rreth trashëgimisë kulturore dhe natyrore kërkon angazhim më të madh në baza vullnetare;
- Në njohuri më të madhe për metodologjinë rreth mënyrës së qasjes ndaj trashëgimisë kulturore, e cila nuk është vërejtur në projektet paraprake;
- Në bashkëpunimin shumëdisiplinor të njerëzve nga sektorë të ndryshëm në regjion së bashku me ekspertë nga fusha dhe nivele të ndryshme;
- Në familjarizimin e pushtetit lokal me trashëgiminë jomateriale kulturore dhe në përkrahjen e rritur për ngjarjet e caktuara (duke përfshirë zakonet e qethjes së deleve në Deçan dhe interpretimet në Sofrën Gjakovare në Gjakovë);
- Në mundësitë e reja për bashkëpunim me vendet e tjera në regjion;
- Në rritjen e njohurive dhe të vetëdijësimit në mesin e mësimdhënësve të shkollave fillore për vlerën e trashëgimisë kulturore dhe të diversitetit;
- Në rritjen e vullnetit dhe të gatishmërisë së palëve vendore me interes që të vazhdojnë me metodologjinë e projektit PDKK, e cila është ofruar përmes seminareve, trajnimeve dhe vizitave studimore;
- Në qasjen regjionale ndaj trashëgimisë kulturore, e cila është praktikuar për herë të parë dhe ka ndikuar pozitivisht tek vendimmarrësit për bashkëpunim të mëtejshëm mes 6 komunave pjesëmarrëse në projekt;
- Në mbështetjen e zyrës në regjionin e Kosovës përëndimore dhe krijimin e perceptimit për nevojën e saj dhe për përkrahjen nga ana e palëve vendore me interes;
- Në rritjen e përfshirjes së grupeve të pakicave, duke demonstruar kështu gatishmërinë për bashkëpunim dhe angazhim në aktivitete e trashëgimisë kulturore brenda bashkësisë më të gjerë.
- Increasing involvement of minority groups, demonstrating a willingness to collaborate and be engaged in cultural heritage activities with the wider community.

UJËVARA/GRYKA E MIRUSHËS, KOMUNA E KLINËS

Gryka e lumit Mirushë është krijuar nga formacionet e karbonit nga periudha e vonshme e Kretakut. Përveç pelizazheve dhe morfologjisë së saj të bukur, gryka po ashtu është magjepsëse për shkak të 13 liqeneve dhe 12 ujëvarave të formave dhe lartësive të ndryshme, të cilat gjenden në rrjedhën e lumit. Në vitin 1983 një pjesë e lumit Mirusha, ku gjendet edhe gryka, është shpallur Park regjional natyror. Ka nevojë për një projekt të zhvillimit të qëndrueshëm të turizmit.



Konsideratat strategjike



Qasja e integruar në planifikimin dhe menaxhimin e trashëgimisë

Zhvillimi i planifikimit dhe zhvillimit të qëndrueshëm të trashëgimisë në përputhje me normat dhe standardet evropiane, me një theks të veçantë në mirëqenien e bashkësisë përmes pjesëmarrjes aktive të të gjitha palëve me interes dhe të shoqërisë civile.

‘Qasja/sektorët e integruar’ do të përfshijnë futjen e sektorit të Turizmit të Trashëgimisë në kuadër të zhvillimit më të gjerë të turizmit. Strategjia nuk do të përqendrohet vetëm në çështjet e trashëgimisë kulturore (materiale dhe jomateriale) dhe natyrore, duke përfshirë ruajtjen, restaurimin, shënjimin, informatat për lokalitetin dhe sigurinë e tij, por gjithashtu do të përfshijë autoritete përgjegjëse për trashëgiminë që funksionojnë në partneritet dhe bashkëpunim me palët e tjera në fushën e turizmit dhe të bashkësisë.

Kjo qasje, e promovuar përmes projektit PDKK, ka potencialin e trajtimit të çështjeve kundërtënëse, duke përfshirë pajtimin dhe integrimin e bashkësive të ndryshme etnike përmes zhvillimit turistik dhe ekonomik të qëndrueshëm, nga i cili do të kishte përfitime të ndërsjella, duke ruajtur njëkohësisht integritetin e trashëgimisë dinamike kulturore që është krijuar me kalimin e kohës. Realizimi i kësaj priteje do të varet nga ndikimi i momentit të duhur komercial që do t'i përgjigjet nevojave të përbashkëta gjatë procesit.

Këto shqyrtime strategjike janë ngushtë të ndërlidhura, dhe mbrojtja e suksesshme e trashëgimisë në Kosovën perëndimore varet nga shkalla e efektshmërisë së bashkëpunimit mes partneritetit publiko-privat. Në mënyrë që mbrojtja të ketë sukses, është qenësore që bashkësitë vendore të jenë plotësisht në dijeni për rëndësinë e asaj që mbrohet, pse ka këtë rëndësi dhe si mund të ndikojnë aktivitetet e popullsisë lokale në këtë mbrojtje. Një plan i shëndoshë i menaxhimit të trashëgimisë duhet të përfshijë diversitetin, i cili kërkon një proces të kujdesshëm të ideimit dhe planifikimit. Asetet e trashëgimisë të mbrojtura, ideuara dhe të menaxhuara mirë dhe me një promovim të duhur, janë thelbësore për zhvillimin e suksesshëm dhe të qëndrueshëm të turizmit të trashëgimisë.

Korniza e Planit të trashëgimisë do të jetë katalizator i rëndësishëm në arritjen e këtij rezultati të dëshirueshëm përmes një numri qasjesh specifike strategjike.

5.1 Vetëdijësimi përfshinë:

- Vlerësimin e strukturave, ndikimeve dhe çështjeve lokale me qëllim të kuptimit më të mirë të nevojave dhe dëshirave të palëve me interes.
- Ngritjen e kapaciteteve në mesin e palëve me interes për ngritjen e vetëdijësimit në nivel lokal dhe regional lidhur me çështjet e trashëgimisë dhe të diversitetit.
- Bashkëpunimin dhe garantimin e nivelit të caktuar të bashkërendimit dhe të konsistencës së qasjes me partnerët relevantë.
- Promovimin e këmbimit të efektshëm të njohurive, të bazuar në hulumtime dhe fakte.
- Sigurimin e përfshirjes dhe pjesëmarrjes të të gjitha bashkësive dhe përfshirjen e ideve të ndryshme.
- Planifikimin dhe ndërmarrjen e aktiviteteve të njëkohshme dhe të duhura të vetëdijësimit për të gjitha bashkësitë dhe autoritetet
- Ofrimin e strategjive dhe resurseve për fushatat lokale të vetëdijësimit, të cilat janë argëtuese dhe arsimore njëkohësisht.
- Ofrimin e mekanizmave për vlerësimin e ndikimit.

5.2 Masat e mbrojtjes

Karakteristikat kryesore të qasjes së integruar në konservimin dhe mbrojtjen e trashëgimisë janë si në vijim:

- Sigurimi i zbatimit të efektshëm të legjislacionit përfshirës dhe të azhurnuar për mbrojtjen e trashëgimisë.
- Shfrytëzimi i ekspertizës së trashëgimisë.
- Hartimi i politikave, programeve dhe planeve të duhura të menaxhimit.
- Vazhdimi i procesit ekzistues të regjistrimit të kategorive të ndryshme të trashëgimisë kulturore në përputhje me kriteret e parapara në Ligjin për trashëgiminë kulturore dhe Udhëzuesve për Inventarizimin e aseteve të trashëgimisë kulturore.
- Monitorimi i zbatimit të projekteve të konservimit në përputhje me kriteret dhe procedurat e përcaktuara, si dhe në ekuilibër me kërkesat e arsyeshme të pronarëve/banorëve si dhe me programet dhe planet e autoriteteve lokale.
- Vetëdijësimi për "Hartën arkeologjike" të regjionit në mënyrë që të mund të ndërmerren masat parandaluese nëse një ndërtim apo aktivitete tjera tentohen të ndërmerren në zonat me karakteristikë arkeologjike.
- Përkrahja e hartimit të udhëzuesve për inkurajimin e mbajtjes, integritetit dhe të përmirësimit të trashëgimisë ekzistuese kulturore dhe natyrore.
- Të qenit vigjilent dhe shfrytëzimi i të gjitha mundësive për inkurajimin e partneriteteve mes institucioneve përgjegjëse, autoriteteve lokale dhe pronarëve, për revitalizimin e trashëgimisë së ndërtuar
- Fokusimi në ndikimin afatgjatë për krijimin e një qasjeje të integruar drejt rrjetit të qëndrueshëm dhe të integruar të parqeve dhe rezervateve kombëtare.

5.3 Planifikimi dhe hartimi

Planifikimi dhe dizajnimi është komponenti kryesor i qasjes strategjike, i cili përfshinë:

- Vlerësimin e thukët me të gjitha palët me interes, posaçërisht me bashkësitë e vendit.
- Analizën reale të kapaciteteve organizative dhe operacionale.
- Bashkëpunimin dhe bashkërendimin e rritur mes institucioneve, shoqërisë civile dhe autoriteteve lokale.
- Planin gjithëpërfshirës për trashëgimi: caktimi i prioritetëve, vlerësimi teknik dhe studimi i fizibilitetit.
- Vëmendje e posaçme duhet t'i kushtohet përfshirjes së bashkësive të marginalizuara.

PUNIMI I SHAMIVE DHE MERHAMAVE, KOMUNA E DEÇANIT

Lidhëset dhe merhama janë një nga karakteristikat më tërheqëse të veshjes kombëtare të grave në regjionin e Pejës. Merhama mbahet në kokë; njëra pjesë e saj është e zbukuruar dhe ka ngjyrë kafeje të mbyllët apo të zezë. Shamia lidhet rreth belit dhe zakonisht ka dy ngjyra. Të dyja janë të dekoruara me zbukurime të ndryshme ornamentale që përfaqësojnë besimet pagane për mbrojtjen e personit që i mban ato nga djalli, por gjithashtu ka elemente të zbukurimeve me bimë, me gjethe dhe me lule. Materialet (mëndafshi dhe pam-buku) blihen në qytet, ndërsa mjetet e punës punohen nga zanatlinjtë vendorë.

Kanë mbetur vetëm edhe disa gra në regjion që ende punojnë këtë zeje. Ky është një produkt tërheqës që duhet të reklamohet si suvenir – një brend unik i fshatrave të regjionit. Ka nevojë urgjente për një plan të organizimit të prodhimit.

- Ndjeshmërinë ndërkulturore për grupet ekzistuese, duke u bazuar në moshë, vendndodhje gjeografike, aftësi, gjini, racë dhe përkatësi etnike.
- Analizën gjithëpërfshirëse të mundësive për grumbullim fondesh dhe për tendenca të tregjeve.
- Fushatën e efektshme të informimit publik.
- Mekanizmin e planifikuar mirë të monitorimit e të vlerësimit, duke llogaritur edhe fazën pasuese.
- Dokumentacionin e dhënë me kohë dhe të saktë.
- Mundësi të duhura për zhvillim profesional.

5.4 Masat e menaxhimit kërkojnë:

- Respektimin e parametrave të përcaktuar nga palët me interes.
- Sigurimin e kontrollit sistematik të cilësisë të mallrave dhe shërbimeve.
- Ruajtjen e ekuilibrit mes detyrave dhe procesit.
- Trajtimin e monitorimit dhe vlerësimit si një proces të të mësuarit.
- Ekuilibrimin e kujdesshëm të resurseve financiare dhe njerëzore, si dhe të aktiviteteve programore.
- Ndërmarrjen e vlerësimeve të rregullta dhe të analizave të të dhënave për të qenë në gjendje të përshtatjes ndaj ndryshimeve.
- Njohjen e lidhjeve dhe mundësive potenciale të bashkëpunimit për ruajtjen e resurseve dhe ndërtimin e partneriteteve.
- Njoftimin e rregullt të palëve me interes për gjendjen e punëve me qëllim të rifuqizimit të angazhimit.
- Promovimin e punëve të kryera me qëllim të prezantimit të progresit dhe tërheqjes së donatorëve, partnerëve dhe investitorëve të brendshëm e të jashtëm.

5.5 Trashëgimia kulturore dhe turizmi:

- Mund të jenë faktori kryesor për zhvillimin ekonomik lokal.
- Projektet e trashëgimisë mund të rrisin turizmin e trashëgimisë kur realizohen në kuadër të pakos së plotë të turizmit të trashëgimisë. Do të ishte mirë të prioritetizohen projektet që ndërlidhen me infrastrukturë të mirë të turizmit dhe me zhvillime komerciale, siç janë restorantet dhe kushtet e akomodimit.
- Sigurimi i përfshirjes dhe integritetit të popullsisë lokale me objektet e tyre të trashëgimisë dhe me zhvillimin e ndërlidhur të turizmit të trashëgimisë.
- Në zhvillimin dhe prezantimin e turizmit të trashëgimisë gjithmonë duhet të kemi parasysh diversitetin kulturor të popullsisë vendore dhe të turistëve.
- Tentoni të paraqisni një histori të balancuar të trashëgimisë dhe të historisë së regjionit, duke u siguruar që prezantimet dhe informatat e dhëna gjithmonë janë të bazuara në njohuritë dhe hulumtimet e shëndosha profesionale.
- Siguroni që një pjesë e arsyeshme e të hyrave nga turizmi i trashëgimisë të investohet në konservimin e trashëgimisë.
- Njohja e rrezikut ekzistues se shfrytëzimi i një dimensionit të trashëgimisë si atraksion turistik në një zonë mund të kërcënojë konservimin apo madje edhe vet ekzistencën e resurseve të tjera të trashëgimisë në atë zonë.
- Të kuptuarit se turistët e trashëgimisë do të presin standarde ndërkombëtarisht të njohura lidhur me infrastrukturën lokale fizike dhe të mikpritjes.
- Para prezantimit të vendeve të trashëgimisë si atraksione turistike, sigurohuni se ekzistojnë masat e nevojshme mbrojtëse.
- Para prezantimit të vendeve të trashëgimisë si atraksione turistike, sigurohuni se janë trajtuar çështjet e ndërlidhura shëndetësore dhe të sigurisë.
- Kuptoni se turizmi jo i bashkërenduar i trashëgimisë mund të nxisë ndikime negative në popullsinë vendore, siç janë humbja e intimitetit, tollvi të shtuara në komunikacion, dëmtimi i pronës dhe i mjedisit lokal publik, si dhe çrregullimi i mënyrës vendore të jetesës.



Objektivat dhe veprimet



Rekomandimet e studimit të fizibilitetit janë fokusuar në realizimin e objektivave të projektit lidhur me diversitetin kulturor, burimet e përbashkëta të trashëgimisë kulturore dhe natyrore dhe me potencialin për turizmin e trashëgimisë në regjion – të gjitha këto të integruara me zhvillimin e përgjithshëm të turizmit, duke marrë parasysh njëkohësisht resurset në dispozicion, autoritetet dhe kufizimet legjislative dhe kufizime të tjera.

Plani i veprimit që është bazë e Planit të trashëgimisë përqendrohet në trajtimin e dobësive të trashëgimisë përmes mënyrës që njih raportin mes trashëgimisë dhe ekonomisë lokale, duke përfshirë turizmin, dhe paraqet vazhdimin dhe diversifikimin e veprimeve tanimë të përfunduara/mbështetura nga grupet punuese regjionale dhe komunale.

Këto veprime kanë përfshirë:

- Themelimin dhe trajnimin e grupeve punuese regjionale dhe komunale.
- Procesin e grumbullimit të të dhënave.
- Vlerësimin e të dhënave për trashëgiminë dhe miratimin e projekteve në çdo komunë.
- Pilot Projektet të përqëndruara në ngjarjet/traditat kulturore në çdo komunë.
- Pilot Projektet për demonstrimin e turizmit të trashëgimisë.

Duke u bazuar në aspektet strategjike të cekura, më poshtë janë paraqitur objektivat dhe veprimet e ndërlidhura, të planifikuara për tri vitet e ardhshme:

Objektivi 1

Vetëdijësimi dhe promovimi i vlerësimit të trashëgimisë në Kosovën perëndimore.

Nr.	Veprimet	Partnerët potencial
1.1	Organizmi i aktiviteteve të ndryshme të promovimit të trashëgimisë me përfshirje aktive të bashkësisë, ku do të theksoheshin zakonet, vendet e trashëgimisë dhe produktet kulturore në rajon	PDKK, mjetet e informimit, profesionistët, OShC-të, QTK, komuniteti i biznesit
1.2	Inkurajimi i aktiviteteve të vetëdijësimit arsimor nëpër shkolla përmes garave, ngjarjeve dhe seminareve.	Shkollat vendore, drejtoritë komunale të arsimit dhe praktikantët
1.3	Hartimi dhe miratimi i strategjisë së përbashkët të vetëdijësimit me të gjitha komunat e përfshira.	OShC-të, PDKK, komunat
1.4	Promovimi i Planit regional për trashëgimi dhe zbatimin e tij përmes një numri aktiviteteve të vetëdijësimit me zyrën për koordinim regjional të menaxhimit të trashëgimisë	Komunat, PDKK
1.5	Rritja e vetëdijësimit rreth qasjes së integruar ndaj trashëgimisë në mesin e autoriteteve dhe qytetarëve në përgjithësi.	PDKK
1.6	Hapja e faqes së internetit që do të promovonte regjionin dhe aktivitetet në zhvillim e sipër.	Zyra regjionale
1.7	Pajisja e zyrës regjionale me materiale promovuese të komunave	Komunat



Objektivi 2

Ndërmarrja e masave të nevojshme për mbrojtjen e trashëgimisë në Kosovën perëndimore

Nr.	Veprimet	Partnerët potencial
2.1	Sigurimi i vlerësimit të vazhdueshëm të pasurive të trashëgimisë.	OSHC-të, QTK
2.2	Inicohet përpilimi i regjistrit të elementeve të trashëgimisë kulturore jomateriale në bashkëpunim me institucionet shkencore dhe me ekspertë.	OSHC-të, pronarët dhe profesionistët e fushës
2.3	Realizimi i pilot projektit për konservimin e artefakteve arkeologjike dhe të artefakteve të tjera të trashëgimisë pas konsultimeve me institucionet qendrore	Instituti i arkeologjisë, komunat, QTK
2.4	Inicohet vlerësimi rural, me vëmendje të posaçme në pasurinë e biodiversitetit dhe të trashëgimisë natyrore, duke përfshirë identifikimin e specieve të rëndësishme më të madhe për konservim në regjion.	MMPH, komunat, OShC-të
2.5	Realizimi i regjistrimit të zonave të peisazheve nga pikëpamja e trashëgimisë	MMPH, komunat, OShC-të
2.6	Krijimi i bazës së të dhënave për muzetë dhe koleksionet e tyre (trashëgimia e luajtshme kulturore).	Muzeu i Kosovës, Instituti Etnologjik, komunat, OShC-të
2.7	Përpilimi i 'Regjistrit të objekteve në rrezik' në mënyrë që të ndërmerren veprime të menjëhershme për ruajtjen e strukturave ekzistuese.	QTK
2.8	Krijimi i hartës me pasuritë e mbrojtura të trashëgimisë kulturore materiale, të elementeve të trashëgimisë kulturore jomateriale, të artefakteve të luajtshme të trashëgimisë dhe të lokaliteteve të trashëgimisë natyrore, duke u bazuar në studime dhe hulumtime gjithëpërfshirëse.	QTK, OShC-të, komunat

Objektivi 3

Zhvillimi dhe inkurajimi i një vlerësimi të plotë, ideimi dhe planifikimi të integruar të projektit me një plan të shëndoshë të menaxhimit të trashëgimisë në Kosovën perëndimore.

Nr.	Veprimet	Partnerët potencial
3.1	Inkurajimi i bashkëpunimit dhe koordinimit mes të gjitha agjencive të trashëgimisë, entiteteve dhe individëve të interesuar në regjion.	QTK, PDKK, komunat
3.2	Organizimi i vizitave studimore në regjionet me sfida dhe projekte të ngjashme.	PDKK, projektet e tjera në regjion
3.3	Shfrytëzimi i mekanizmave të menaxhimit të njohura nga procesi i Lubjanës të KE/BE-së.	QTK, komunat, Departamenti i turizmit i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë
3.4	Organizimi i forumeve të rregullta regjionale të trashëgimisë me qëllim të informimit të vazhdueshëm të palëve me interes.	Zyra regjionale
3.5	Botimi i një reviste vjetore, të quajtur 'Analiza e gjendjes së turizmit të trashëgimisë në Kosovën perëndimore', këmbimi i rezultateve të hulumtimit dhe të vlerësimit.	Zyra regjionale
3.6	Dhënia e qasjes së rregullt dhe të duhur në lokalitetet e përzgjedhura të trashëgimisë me perspektivë turistike, duke përfshirë edhe vendosjen e shenjave dhe dhënie informatave.	QTK, komunat

Objektivi 4

Zhvillimi dhe bashkërendimi i praktikave të duhura të menaxhimit për ruajtjen e trashëgimisë në Kosovën perëndimore

Nr.	Veprimet	Partnerët potencial
4.1	Hartimi i udhëzuesve dhe formularëve të tjerë si praktika më të mira.	QTK, PDKK
4.2	Bashkërendimi i analizave dhe shqyrtimeve vjetore mbi implementimin e Planit të trashëgimisë dhe përgatitjes së planit të ardhshëm të trashëgimisë në vitin 2014 për një periudhë tjetër trevjeçare.	Zyra regjionale
4.3	Sigurimi i shërbimeve më cilësore për turizmin e trashëgimisë përmes zhvillimit profesional.	GPNM, PDKK
4.4	Zhvillimi i një qasjeje të integruar ndaj programeve të rehabilitimit, turizmit dhe të arsimit me partnerë të shumtë.	PDKK, komunat, OShC-të
4.5	Planifikimi i programeve të përshtatura me kërkesat e tashme dhe të ardhshme turistike	Komunat, OShC-të, komuniteti i biznesit
4.6	Përgatitja e planeve të menaxhimit për rehabilitimin e trashëgimisë kulturore, të paluajtshme, jomateriale dhe natyrore të përzgjedhur, përmes dialogut aktiv ndërkulturor midis të gjitha palëve me interes (autoriteteve qendrore dhe lokale), duke përfshirë komunitetet e marginalizuara.	Projektet që funksionojnë në regjion, QTK
4.7	Hartimi i udhëzuesve për mirëmbajtjen e trashëgimisë së ndër-tuar dhe të lokaliteteve arkeologjike, duke u bazuar në praktikat më të mira	QTK

Objektivi 5


Krijimi i nismave të duhura dhe të qëndrueshme të turizmit të trashëgimisë në Kosovën perëndimore

Nr.	Veprimet	Partnerët potencial
5.1	Inicimi i një programi trajnues për ciceronë vendorë të trashëgimisë që do të punonin me gjysëm orari në çdo komunë.	GPNM, PDKK
5.2	Pjesëmarrja në pilot projekte demonstruese të turizmit të trashëgimisë, duke përfshirë edhe shtigjet e trashëgimisë kulturore.	PDKK
5.3	Realizimi i analizës së kosto/përfitimit për projektin në tërësi dhe për projektet veç e veç me qëllim të lehtësimit të caktimit të prioritetëve të projektit dhe të aplikimit për fonde	QTK, komunat, kompanitë hulumtuese
5.4	Përgatitja e regjionit të Kosovës perëndimore si një destinacion i turizmit të trashëgimisë	OSHC-të, komunat, zyra regjionale
5.5	Krijimi i mundësive për integrimin e trashëgimisë kulturore dhe sektorëve të turizmit.	OSHC-të, komunat, zyra regjionale
5.6	Zhvillimi i shërbimeve bazë të turizmit, që do të ofrohen nga NVM-ët (biznese familjare)	Kompanitë huadhënëse, bankat, PDKK, komunat
5.7	Përkrahja e praktikave dhe aseteve të trashëgimisë kulturore jomateriale përmes aplikimit të përgjegjshëm të industrive kreative.	OSHC-të, komunat, zyra regjionale, komuniteti i biznesit.

Plani i veprimit do të monitorohet nga zyra regjionale koordinuese për diversitetin kulturor dhe menaxhimin e trashëgimisë, e cila përfshinë grupet punuese regjionale dhe komunale, dhe do të përkrahet nga projekti PDKK.



Zbatimi i Planit të trashëgimisë – shkuarja përpara



Zbatimi i Planit regional të trashëgimisë është pjesë thelbësore e procesit, ku përfshirja aktive dhe e rritur e palëve vendore me interes do të luajë rol kyç për efektshmërinë e saj. Pasi që ky plan është i pari i këtij lloji në Kosovë, do të ruhet lidhja e ngushtë me projektin e PDKK-ës gjatë tri viteve të ardhshme. Përveç kësaj, lidhja profesionale e krijuar me Këshillin e Trashëgimisë të Irlandës do të jetë si një vlerë e shtuar në ofrimin e përkrahjes teknike. Po kështu, lidhjet e krijuara me 'Parkun regional natyror Vosges North' në Francë do të ndihmojnë në shkëmbimet profesionale gjatë fazës së implementimit në periudhën vijuese. Implementimi i Planit të trashëgimisë do të lehtësohet përmes një mekanizmi të fuqishëm monitorues.

Zyra për Promovimin e Menaxhimit të Trashëgimisë – Perëndim (PMT) e lidhur ngushtë me projektin e PDKK-ës, është paraparë të jetë si një grup ekspertësh regionalë, i cili do të bëjë hulumtime të thukëta dhe do të grumbullon të dhëna për regjionin, duke bërë analiza krahasuese dhe duke i futur ato në strategjitë dhe planet e hartuara në nivel lokal. Ky entitet për më shumë do të krijoj dhe mban lidhje me donatorët vendorë dhe ndërkombëtarë, me regjionet e tjera në Kosovë dhe autoritetet qendrore, për të kontribuar kështu në mënyrë aktive në programet në mbarë Kosovën.

Duke u bazuar në informatat e grumbulluara, zyra ndihmon fushatat për vetëdijesimin e qytetarëve dhe aktivitetet promovuese për diversitet dhe trashëgimi të regjionit, me fokus të veçantë në turizmin e trashëgimisë. Përmes vlerësimit të vazhdueshëm, zyra luan një rol të katalizatorit për ruajtjen dhe menaxhimin e trashëgimisë kulturore dhe natyrore në bashkëpunim me të gjitha palët me interes. Zyra ofron të dhëna të sakta dhe faktike për hartimin e strategjive dhe planeve për menaxhim e trashëgimisë.

Përmes zhvillimit të kapaciteteve në nivel lokal, këto plane do të përgatiteshin nga palët vendore me interes brenda bashkësive lokale në përputhje me ligjet dhe rregulloret e përcaktuara nga autoritetet qendrore. Kjo zyrë siguron lidhjet dhe dialog të vazhdueshëm midis entiteteve të ngjajshme dhe bashkësive. Pasi që turizmi i trashëgimisë është thelbësor për zhvillimin ekonomik lokal, objektivi i zyrës do të jetë promovimi dhe avokimi për trashëgiminë kulturore dhe natyrore në procesin e zhvillimit të turizmit të trashëgimisë, ku turizmi do t'i kushtojë vëmendje të posaçme mbrojtjes, ruajtjes dhe menaxhimit të trashëgimisë dhe diversitetit.

Përderisa projekti i PDKK-ës do të jetë i lidhur ngushtë me këtë zyrë, besohet se roli thelbësor i zyrës është kuptuar drejt dhe do se të ketë mbështetjen nga të gjitha palët e interesit, duke u bërë gradualisht pjesë efektive e strukturave lokale.

Funksionet e zyrës regjionale koordinuese janë:

- Hulumtimi
- Promovimi
- Veprimet inovative
- Zhvillimi profesional
- Mbështetja për bërje të Strategjisë dhe Planit të Trashëgimisë

MALI I KOZHNERIT (REZERVAT I DHISË SË EGËR), KOMUNA E DEÇANIT

Kozhnjeri (1708 m) është i njohur për biodiversitetin që ka por edhe për karakteristikat gjeologjike, gjeomorfologjike, spelologjike dhe hidrike. Rëndësia e kësaj zone qëndron në ekzistimin e dhisë së egër (*Rupicapra rupicapra*), lloj i rrallë i gjitarëve që ka shtrirje vetëm në zonat e thella malore dhe shkëmbore.

Kjo është poashtu habitat i shqiponjës minjngrënëse (*Buteo buteo*), pulëgrës së madhe (*Tetrao urogallus*) dhe thëllëzës së gurit (*Alectoris graeca*). Në vitin 1955 zona e Kozhnjerit (150ha) është vënë nën mbrojtje strikte.


Ka nevojë për një politikë mbrojtëse për këtë biodiversitet të veçantë.



Stoli argjendi, punëdore

Strategjia afatgjate

Derisa PLANI i parë i TRASHËGIMISË është hartuar në regjionin e Kosovës perëndimore, gjatë tri viteve të ardhshme do të hartohen më shumë plane regjionale të trashëgimisë në bazë të kërkesave të grupeve regjionale të punës në partneritet me autoritetet e tyre komunale. Numri i planeve të trashëgimisë do të bazohet në strukturën e re operacionale të MKRS-së dhe në bazë të metodologjisë së krijuar gjatë projektit të PDKK-së. Regjionet e interesuara do të involvohen në proces, duke hartuar njëkohësisht dhe në mënyrë progresive planet e tyre të trashëgimisë, të cilat gradualisht do t'i kontribuojnë Planit mbarëkosovar të trashëgimisë.



Shtojcat

Shtojca 1 – Vendet e trashëgimisë & traditat e vlerësuara gjatë vitit 2011

Vendet e trashëgimisë dhe traditat e paraqitura në vijim, të ndara sipas komunave, janë vlerësuar në vitin 2011 gjatë punës integruese në feren të Planit të trashëgimisë për rajonin. Vendet e paraqitura të trashëgimisë janë vetëm mostër e trashëgimisë së pasur dhe të llojllojshme të rajonit. Puna e vazhdueshme sipas Planit të trashëgimisë do t'i pasurojë më tej këto lista në bazë të një planifikimi me rritje progresive. Ky angazhim i hershëm dhe progresiv i komunitetit me vendet e trashëgimisë dhe traditat është tipar dallues i procesit të Planit të trashëgimisë që zbatohet në Kosovë.

Komuna e Pejës

Trashëgimia e materiale e komunës së Pejës

Xhamia Bajrakli
Hamami i Haxhi beut
Mulliri i Haxhi Zekës
Hani i Tahir Begut
Kulla e Goskajve
Kulla e Qamil Limanit
Kulla e Zenel beut
Xhamia Kurshumli
Qarshija e vjetër
Patriarkana e Pejës

Trashëgimia e jomateriale e komunës së Pejës

Punuesi i plusave

Trashëgimia natyrore e komunës së Pejës

Burimi i Drinit të Bardhë
Shpella e Grykës së Madhe
Gryka e Rugovës

Komuna e Gjakovës

Vendet e trashëgimisë materiale të komunës së Gjakovës

Muzeu etnografik
Xhamia e Hadumit
Sahat Kulla
Kulla e Koshit
Teqeja e Sheh Eminut
Ura e Tabakut
Ura e Taliqit
Ura e Terzive
Hani i Haraqisë

Trashëgimia e Jomateriale e komunës së Gjakovës

Zeja e djep punuesve

Trashëgimia natyrore e komunës së Gjakovës

Gryka e Drinit të Bardhë

Liqeni i Radoniqit

Parku i Shkugëzës

Komuna e Deçanit

Vendet e trashëgimisë materiale të komunës së Deçanit

Kulla e Demukajve

Kulla e Kuklecajve

Kulla e Mazrekajve

Kulla e Osdautajve

Kulla e Mushkolajve

Manastiri i Deçanit

Xhamia e Deçanit

Mulliri i Shabanajve

Mulliri i Tahir Sadrisë

Trashëgimia jomateriale e komunës së Deçanit

Endja tradicionale në vek

Trashëgimia natyrore e komunës së Deçanit

Bjeshkët e Prejlepit

Bjeshka e Kozhnjerit

Pishat e Deçanit

Komuna e Istogut

Vendet e trashëgimisë materiale të komunës së Istogut

Ura e Gurit në Zallq

Kisha e Shën Gjonit

Kulla e Qerim Rugovës

Mulliri i Qetë Bicajt

Trashëgimia e Jomateriale e komunës së Istogut

Darka e Lamës

Trashëgimia natyrore e komunës së Istogut

Burimi i ujërave termal

Burimi i ujërave natyror

Komuna e Klinës

Vendet e trashëgimisë materiale të komunës së Klinës

Kulla e Mark Jakajt
Muzeu privat

Trashëgimia jomateriale e komunës së Klinës

Veshja tradicionale e grave 'Reka'

Trashëgimia natyrore e komunës së Klinës

Shpella e Azem Bejtës
Shpella e Dushit
Ujëvarat e Mirushës

Komuna e Junikut

Vendet e trashëgimisë materiale të komunës së Junikut

Kulla e Ramë Zymberit
Kulla e Jah Imerit
Xhamia e Çokut

Trashëgimia e jomateriale e komunës së Junikut

Loja kuta klic
Garat me kuaj

Trashëgimia natyrore e komunës së Junikut

Lumi i Erenikut
Peizazhi i Moronicës
Maja dhe liqenet e Gjeravicës

Shtojca 2 – Referencat & burimet e përzgjedhura

Aliu V.- Drançolli F. – Haliti Nj. & Zeneli A. (2005). "Trashëgimia e evidentuar e Kosovës/ Evidentiranih spomenici na Kosovu/Evidences Monuments of Kosova". Prishtinë, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

ARD-BIOFOR IQC Consortium on behalf of USAID/Kosovo (2003). "Kosovo Biodiversity Assessment". Prishtinë, USAID/Kosovo.

Drançolli F. (2007). "Xhamia e Hadumit, Çarshia e Gjakovës/Hadum Mosque, Bazaar in Gjakova". Prishtinë, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Dečani i vizantijska umetnost sredinom XIV veka (1989). Beograd.

EU CARDS programme for Kosovo (2009). "Sustainable Forest Management for Kosovo – Technical Report: Preliminary Identification of Natura 2000 sites in Kosovo. Prishtinë

GTZ on behalf of Department of Tourism, Ministry for Trade & Industry (2010). "Tourism Strategy Kosovo 2010-2020"(draft). Prishtinë, Ministry of Trade & Industry.

Government of Ireland (2002). "National Heritage Plan".

Heritage Council in association with South Dublin County Council (2010). "Heritage Plan 2010 – 2015/ Plean Oidhreachta, Contae Atha Cliath Theas 2010 –2015". Dublin.

Institute for Protection of Monuments in Pejë/Peć (2006). "Monumentet kulturo-historike – Pejë/Historical and cultural monuments-Peja/Kulturno historiski spomenici-Peć". Pejë, Litografia.

Irish Heritage Council, (July 2003). "A Methodology for Local Authority Heritage Officers on the Preparation of County/City Heritage Plans".

Note: the methodology and examples of Irish heritage plans may be downloaded from the Heritage Council website – <http://heritagecouncil.ie>

NGO 'Arteza' (2010). "Gjakova City&Valbona Valley", tourist guide. Gjakovë, Erpoptint.

O'Regan T. (2011). "Feasibility Study Report on Cultural Heritage Tourism Development in the Pejë/Peć Region". Prishtinë/Priština, JP- EU/CoE Support to the Promotion of Cultural Diversity.

Petkovic S. (1982). "Das Patriarchat von Pec". Beograd.

Rizvanoalli M. (2009). "Çarshia e Madhe e Gjakovës/Grand Bazaar of Gjakova. Gjakovë, Erpoptint.

UBO Consulting (2010). "Survey on the Possibilities of Cultural Tourism Development in Pejë/Peć Region". Prishtinë/Priština, JP- EU/CoE Support to the Promotion of Cultural Diversity.

West Regional Development Agency (2010). "West Kosovo – Working Together for a Better Future: Regional Development Strategy 2010-2013". Pejë/Peć, West RDA – EU founded project.

Weitzmann K. – Chatzidakis – Miatev K. & Radojčić S. (1972). "Ikone sa Balkana". Beograd

Shtojca 3 – dokumentet e përfshira në diskun e bashkangjitur

1. Analizë e mundësive për zhvillim të turizmit kulturor
2. Raporti i Studimit të Fizibilitetit mbi zhvillimin e turizmit kulturor
3. Broshurë mbi pilot aktivitetet, Pejë
4. Broshurë mbi pilot aktivitetet, Gjakovë
5. Broshurë mbi pilot aktivitetet, Deçan
6. Broshurë mbi pilot aktivitetet, Junik
7. Broshurë mbi pilot aktivitetet, Istog
8. Broshurë mbi pilot aktivitetet, Klinë



JP - EU/CoE Support to the
Promotion of Cultural Diversity (PCDK)

Funded
by the European Union



Implemented
by the Council of Europe